



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 13 shkurt 2018
Nr. ref.: RK 1196/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI102/17

Parashtrues

Meleq Ymeri

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-stazhit pensional të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Meleq Ymeri (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), jurist i diplomuar nga fshati Kuk, komuna e Dragashit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Udhëzimin Administrativ nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-stazhit pensional (në tekstin e mëtejme: Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015), të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: MPMS).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015, të MPMS-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (1) (7) të Kushtetutës, në nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 gusht 2017, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 22 gusht 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërzhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 12 tetor 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 16 tetor 2017, Gjykata e dërgoi një kopje të kërkesës në MPMS.
9. Më 10 janar 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 31 dhjetor 2015, MPMS-ja publikoi Udhëzimin Administrativ nr. 09/2015, në Gazetën Zyrtare.
11. Më 21 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës kontestoi kushtetutshmërinë e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi pretendon se dispozita e nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 është “diskriminuese meqë nuk ka mbështetje juridike, pa arsyetim,

pa fakte, dhe argumente ... kufizon të drejtat me një datë të supozuar 01.01.1991...".

13. Parashtruesi më tej pretendon shkelje të neneve 47 [E Drejta për Arsimin] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.
14. Për sa i përket obligimit për shterimin e mjeteve juridike, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës u shpreh: *"ky është një akt i një autoriteti publik, dhe se e vetmja Gjykata Kushtetuese ka tagër për ta bërë vlerësimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë"*.
15. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të konsiderojë: *"... se kërkesa ime është e drejtë dhe e ligjshme, duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që ta vlerësojë ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 respektivisht dispozitën e fundit të nenit 5 e cila është super diskriminuese"*.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar;

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

18. Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës, që specifikon:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(a) Kërkesa shtrohet nga një palë e autorizuar".

19. Për sa i përket kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk ka dëshmuar se si akti i kontestuar ka cenuar të drejtat dhe liritë e tij themelore. Gjykata rithekson se teksti kushtetues dhe jurisprudenca e kësaj Gjykate nuk ua njohin të drejtën individëve që të kontestojnë *in abstracto* akte të karakterit të përgjithshëm. (Shih për këtë qëllim, mes shumë referencave, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: aktvendimet për papranueshmëri në rastet nr. KI92/12 parashtrues Sali Hajdari; KI62/12

parashtrues Liridon Aliu; KI40/11 parashtrues Zef Prenaj; KI51/10 parashtrues Ljubiša Živić).

20. Gjykata përsërit se Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh *actio popularis*, që do të thotë se individët nuk mund të ankohen në abstrakt ose t'i sfidojnë drejtpërsëdrejti veprimet ose mosveprimet e autoriteteve publike. Kushtetuta e Kosovës ofron mbështetje për individët sa i përket veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve publike vetëm përbrenda fushëveprimit të përcaktuar me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, që kërkon nga parashtruesit të tregojnë se janë: (1) palë të autorizuar, (2) të prekur drejtpërsëdrejti nga akti konkret ose mosveprimi i autoriteteve publike, dhe (3) se kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: rasti nr. KI39/11, parashtrues *Tomë Krasniqi*, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit nr. 311/07, të 13 prillit 2007, dhe Vërtetimit nr. 322/07, të 30 prillit 2007, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 janarit 2013, paragrafi 40 dhe referencat e përmendura aty).
21. Në këtë drejtim, Gjykata nënvizon se juridiksioni i saj procedural dhe material për vlerësimin e akteve me karakter të përgjithshëm vihet në lëvizje vetëm nga institucionet kushtetuese, sipas procedurës së përcaktuar me nenin 113 të Kushtetutës; kurse individët, kanë të drejtë të kontestojnë vetëm aktet individuale të autoriteteve publike-që cenojnë të drejtat e tyre individuale- dhe vetëm pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike, të përcaktuar me paragrafin 7, të nenit 113 të Kushtetutës.
22. Rrjedhimisht, kërkesa në baza kushtetuese, duhet të shpallet e papranueshme sepse nuk është dorëzuar në mënyrë ligjore nga personi i autorizuar siç përcaktohet me paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës, më 10 janar 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

